



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, nr. 03/L-040, Ligjin e Punës nr. 03/L-212 dhe Rregulloren (QRK) për përcaktimin e orarit të punës dhe pushimet e zyrtarëve publik nr.12/2020, merr:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

1.Orari i punës për nëpunësit publik të Administratës komunale sipas rregullit fillon nga ora 8.00, dhe përfundon në orën 16.00, ndërsa pauza prej orës 12.00 – 13.00, dhe atë pesë ditë në javë, nga dita e hënë deri në ditën e premte.

2.Me qëllim të krijimit të kushteve për ofrim të pandërprerë të shërbimeve për qytetarë, sektorët dhe shërbimet përkatëse të punëve me palë, riorganizojnë punën dhe orarin e punës, në mënyrë që këto shërbime të kryhen pa ndërprerë nga ora 8:00 deri në orën 16:00.

#### **Neni 2**

Drejtorët e Drejtorive përkatëse në bashkëpunim me Zyrën e Personelit bëjnë riorganizimin e orarit të punës sipas paragrafit 2 të nenit 1 të këtij vendimi.

#### **Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

*I dërgohet:*

*Drejtorëve të Drejtorive*

*Menaxherit të Personelit*

*Arkivit*

**Nr. prot. 02-104/03-0074521/20**  
**Podujevë, 08 dhjetor 2020**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**

